

PARADOKSI I MARSHIMIT
PËR FAMILJEN, NË TIRANË?



JONUZ TAFILAJ DHE FJALORTHI
I TIJ I GJUHËS SHQIPE
I VITIT 1931



"NA SHQYPTARËT E KËTIJ
VILAJETI I FALENA NDERES MA
S'PARIT GJEVERIS T'STAMBOLLËS..."

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 22 - Nr. 5 (255), Maj, 2024

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

Paradoksi i marshimit për familjen..!



Xhamia "Sulejmanije", Stamboll

PSE QUHET ÇLIRIMTAR I KOSTANDINOPOJËS
SULLTAN MEHMETI (FATIHU)
29 MAJ 1453

BASHKIA E BOLONJËS NË ITALI
NGRE FLAMURIN PALESTINEZ..!

IMAM DIDMAR FAJA:
"MEDRESEJA JONË NË ARIZONA,
DERË E HAPUR E DIJES!"

TAKIM PERIODIK
MË IMAMËT E SHKODRËS

"JEHONA E ZEMRAVE" - 15 VITE

EKSKURSIONE EDUKUESE
DHE ARGËTUESE ME NXËNËSIT
E MEJTEPEVE

PARADOKSI I MARSHIMIT PËR FAMILJEN, NË TIRANË?



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Para disa kohësh nga kjo xhami, kam folur rreth një teme që ka të bëjë me një hadith të Pejgamberit (a.s), i cili doli një ditë dhe i bëri pyetje sahabëve të tij. Pyetja e Pejgamberit (a.s) në të vërtetë, edhe sot kur lexohet, është për të na vënë në alarm për realitete të çuditshme, që do t'i vijnë ymetit islam dhe botës, deri në ditën e fundit. Pyetja e Pejgamberit (a.s) kishte të bënte me urdhëresën për të mirë dhe ndalimin e të keqes.

Pejgamberi (a.s) i thoshte sahabëve të tij se: "Çfarë do të jetë me ju atë ditë kur nuk do të urdhëroni më për të mirë dhe nuk do të ndaloni të keqen?" Sahabët i thonin: "A do të ndodhë kjo edhe në mesin e muslimanëve?", dhe Pejgamberi (a.s) i thoshte se, edhe më keq se kaq do të ndodhë! Çfarë ka më keq se kaq?- i thonin sahabët. Pejgamberi (a.s) vazhdonte e vazhdonte. Hadithi është shumë i njohur dhe njëkohësisht është një tërheqje e vëmendjes për realitetet si tonat!

Kur e kthen kokën pas dhe vendos realitetin e sotëm shqiptar në peshoren e këtij hadithi, e kupton shumë mirë se shumë ekuilibra janë prishur dhe shumë ujëra kanë dalë nga shtrati i tyre.

Ka ardhur koha që shumë njerëz struken e fshihen, gjithsecili në qoshkun e tij, dhe thonë: "Çfarë më duhet mua, më mjafton vetja ime, familja ime, le të prishet bota!"

Jo! Gjithsecili nga ne duhet ta ketë kurajon si besimtar, ta jetojë e ta dëshmojë fenë e tij, ta thotë fjalën e tij, të mos ketë ndrojtje dhe frikë për ta mbrojtur të vërtetën e tij, edhe nëse krejt bota është prishur. Ju do të më thoni se ku është qëllimi i kësaj hyrje? Nëpërmjet rrjeteve sociale jemi lajmëruar se, ditën e sotme, nëse nuk jam gabim, në Tiranë, një organizatë shoqërore e quajtur "Mexhlis", e drejtuar nga disa vëllezër të mirë, me të cilët Allahu (xh.sh) më ka bashkuar në Haxh para pak vitesh, organizojnë një marshim "Pro familjes!" Ti do të thuash çfarë ka në këtë organizim? Në këtë organizim ka shumëçka të mirë! Por, a nuk është paradoks i madh që në Shqipëri dhe në Tiranë, në kryeqytetin e Shqipërisë, në vitin 2024, organizimet shoqërore të thërrasin njerëzit për të marshuar pro familjes? Pra, në 2024, ka degraduar shoqëria shqiptare dhe realiteti shqiptar deri në atë pikë, sa të kërcënohet familja dhe të lëkundet tabani ynë kombëtar dhe organizimi më i shenjtë dhe më i shëndoshë i historisë së njerëzimit?! Çfarë ka ndodhur? Ejani të kthehemi paksa në kohë.

Para disa vitesh në një prej mediave më të bujshme këtu në vendin tonë, një person që ia kam harruar emrin dhe që s'e di se ia kam mësuar emrin e tij ndonjëherë, por që mbante ofiqin e Avokatit të Populllit ishte përballë me shokun dhe vëllanë tim, imamin e xhamisë "Dine Hoxha", H. Ahmed Kalaja. Avokati i Populllit, me shumë gjakftohtësi i thotë njërit prej imamëve më të rëndësishëm të kryeqytetit se: Nëse ti në predikimet e tua flet sot për historinë e Hz. Lutit (a.s) e për fëlliqësinë e populllit të tij, ti dhe Kur'ani yt, shkoni në burg!?

Allah! Pra, duhet të mendojmë sot, se kur flasim në hytbet e xhumasë apo në predikimet tona, për historitë e pejgamberëve dhe sëmundjet e popujve të tyre, duhet të kemi kujdes se pas dritareve mund të jetë Avokati i Populllit apo mashat e tij. Pastaj mund të shkojmë në burg, unë dhe Kur'ani!? Kjo, jo vetëm që nuk është normale, por ky është një paradoks i neveritshëm, që nuk mendoj se mund të ketë ndodhur përgjatë rrjedhave të historisë së njerëzimit!

Po përse marshimi "Pro familjes"? Çuditërisht para disa ditësh pamë në atë që quhet tarraca e institucionit të Bashkisë së Tiranës, një veprim të çuditshëm e të ndaluar ligjërisht në vendin tonë e që paradoksalisht me praninë e nënkryetares së Bashkisë së Tiranës, jo vetëm që u legjitimua, por u bë publik dhe i bujshëm. Personazhet e atij akti të papranueshëm, vazhdojmë t'i shohim edhe sot e kësaj dite në shumë prej mediave duke u marrë në pyetje, sikur të kishin shpikur apo të kishin sjellë në dritë zbulimin më të rëndësishëm të jetës së racës njerëzore!

E para, është e papranueshme që institucioni i Bashkisë së Tiranës të kthehet në një fushë gabi, ku kushdo, kur të dojë e si të dojë në çoroditjen e tij morale, shpirtërore, intelektuale e njerëzore, mund të vijë dhe të predikojë të tijën, pa i hyrë ferrë në këmbë!

> **"Politikat që thërrasin drejt shoqërisë së hapur, dhe për fat të keq e drejtojnë këtë vend prej dekadash, patjetër që e marrin për dore individin dhe shoqërinë shqiptare drejt greminave, drejt shkatërrimit e drejt prishjes së tabanit tonë kombëtar e njerëzor dhe njëkohësisht tërheqin mallkimin dhe dënimin e Allahut (xh.sh)!**

Politikat që thërrasin drejt shoqërisë së hapur, dhe për fat të keq e drejtojnë këtë vend prej dekadash, patjetër që e marrin për dore individin dhe shoqërinë shqiptare drejt greminave, drejt shkatërrimit e drejt prishjes së tabanit tonë kombëtar e njerëzor dhe njëkohësisht tërheqin mallkimin dhe dënimin e Allahut (xh.sh)!

Prandaj, do të ishte e udhës që në këtë kontekst, qeveria shqiptare, kryeministri ynë, meqë është vetë prind; deputetët e vendit tonë, meqë shumica e tyre janë prindër; mos të kalojnë projektligjin për legjitimimin e abortit edhe surrogaçërinë. E vetmja deputete prej deputetëve të Shkodrës, prof. Greta Bardeli më ka telefonuar disa herë dhe e kam vlerësuar maksimalisht qëndrimin e saj dinjitoz, në parlamentin e vendit tonë, në mbrojtje të asaj që është tabani jonë kombëtar, tabani ynë i familjes.

Do të dëshiroja që edhe deputetët e tjerë të Shkodrës, ca të njohur e ca anonimë, të kishin qëndrime dinjitoze, pa dallim partish, kur bëhet fjalë për familjen e kur bëhet fjalë për të ruajtur atë që është e shenjtë nga Zoti i Gjithësisë. Nuk ka as të djathë e as të majtë, por ka bashkim për të ruajtur vendin, për të ruajtur shoqërinë e për të ruajtur realitetin tonë nga kthetrat e shejtanit dhe sekteve të devijuara!

Prandaj, respekti ynë maksimal dhe mirënjohja më e madhe e më e thellë për të gjithë deputetët të cilët e ruajnë ujin e fytyrës dhe e ruajnë tabanin, e refuzojnë devijimin dhe shthurjen dhe nuk pranojnë asnjë prej thirrjeve për të legjitimuar në këtë tokë të bekuar nga Zoti, atë çfarë tërheqë mallkimet dhe dënimin e Tij.

Të dashur dhe të shtrenjtë!

Kam kërkuar gjatë këtyre ditëve në Kur'anin Famëlartë dhe kam gjetur se grupi i ajeteve më të përshtatshme i vendosur përpara duarve tuaja, është grupi i ajeteve 73-76 në suren e Hz. Hudit (a.s). Krejt historia është e përfshirë në këto katër pesë ajete. Për çfarë bëjnë fjalë këto ajete të Hz. Hudit (a.s)? Ato bëjnë fjalë për sihariqin e madh që Zoti i Gjithësisë i dha Hz. Ibrahimit (a.s) dhe gruas së tij, të dy në moshë të thyer.

Erdhën melekët dhe i dhanë sihariq se Zoti do t'i falte një djalë. Kjo përmendet në disa vende në Kur'an.

Gruaja e Hz. Ibrahimit (a.s) thoshte: "Unë të bëj fëmijë në këtë moshë?!" Hz. Ibrahimi (a.s) e dinte se këta janë melekët e Allahut dhe meseleja është e mbyllur. Melekët i thanë: "A po habitesh ti nga vendimi i Allahut? Mëshira e Allahut dhe begatia e Tij qoftë për ju o Ehlibejt, (pra o banorë të kësaj familjeje të bekuar)!"

Hz.Ibrahimi (a.s) i kishte vendosur për të ngrënë sepse ishte mikpritës i madh. Por, ata nuk hanin se ishin melekë! Melekët nuk hanë, as nuk pinë! Ata nuk e zgjatën dorën për të ngrënë dhe Hz. Ibrahimi u frikësua. Pasi melekët u prezantuan, i thanë se kanë ardhur për të shkuar tek populli i Lutit (a.s), që do të ndëshkoheshin në një mënyrë të llahtarshme. Hz. Ibrahimi (a.s) filloi të debatonte me melekët.

Në shumë prej tefsirëve që kam lexuar, në funksion të kësaj, transmetohet se Hz. Ibrahimi i tha melekëve: "Po sikur në popullin e Lutit (a.s) të jenë pesëdhjetë besimtarë a do të ndëshkohen?". Melekët thanë: Jo!

- Po sikur të jenë dyzet a do t'i ndëshkoni? Melekët thanë: Jo!

- Po sikur të jenë tridhjetë besimtarë a do t'i ndëshkoni? Melekët thanë: Jo.

Dhe vazhdoi ta ulte e ta ulte derisa tha: - Po sikur të jenë pesë prej tyre, besimtarë?

Melekët thanë nuk ndëshkohen, as nëse janë pesë prej tyre besimtarë. Pra nuk ishin as 5!?

Imagjinoni o vëllezër, sa populll i madh e sa i shthurur ishin e sa besimtarë kishte në atë populll!? Kuptoni nga kjo se sa fatmirësi e madhe është për një shoqëri, kur në mesin e tyre ka besimtarë! Prania e besimtarëve vepërmirë, mbi të gjitha, është garanci që të mos zbresë ndëshkimi i Allahut në një populll! Prandaj të keni frikë Allahun! Prania e zotërive me mjekra të bardha, e haxhilerëve në mesin tonë, atyre që vijnë me tespih dhe bëjnë dhikër ditë-natë, që falin namazet me rregull, që bëjnë vepra të mira, është ndërmjetësim tek Allahu (xh.sh), që të mos ndëshkohemi!

Hz. Ibrahimi (a.s) e dinte se melekët nuk kanë ardhur nga vetja e tyre, por me urdhër të Allahut. Për të treguar zemërgjerësinë e tij të madhe u tha: "Aty është Luti!" Melekët i thanë: "Ne e dimë se kush është në atë vend! Do ta shpëtojmë atë dhe fëmijët e tij, përveç gruas së tij, e cila është me të shkatërruarit!"

I lavdëruar qoftë Allahu! Grua pejgamberi, mirëpo që ka prerë në besë burrin e saj! Grua pejgamberi, por që është me të shkatërruarit! Dhe ashtu ndodhi. Shkuan tek Hz. Luti (a.s) dhe ndëshkimi ishte ndër më të frikshmit e historisë së njerëzimit. Thuhet se Xhibrili (a.s) me krahët e tij e mori tokën, ku ishte populli i Lutit që vepronin atë fëlliqësi të madhe, e që sot, lajmërohet me të madhe dhe bëhen parada e mbështeten nga ambasada e nga njerëz, sikur të ishte arritja më e madhe e historisë së njerëzimit!?

Me krahët e tij e mori tokën dhe i përmbysi ata dhe jo vetëm kaq, por Allahu (xh.sh) i gjuajti me gurë të zjarrtë. Një shfarosje e frikshme! Përtej thirrjeve të pejgamberit e përtej dëshirës së mirë të Hz. Lutit (a.s), që ata të pendohen dhe të kthehen, ata as u penduan dhe as u kthyen. Madje e tepruan me sjelljen e tyre arrogante.

> **"Do të dëshiroja që edhe deputetët e tjerë të Shkodrës, ca të njohur e ca anonim, të kishin qëndrime dinjitoze, pa dallim partish, kur bëhet fjalë për familjen e kur bëhet fjalë për të ruajtur atë që është e shenjtë nga Zoti i Gjithësisë. Nuk ka as të djathë e as të majtë, por ka bashkim për të ruajtur vendin, për të ruajtur shoqërinë e për të ruajtur realitetin tonë nga kthetrat e shejtanit dhe sekteve që shejtani i ka dalë për zot.**

I lavdëruar qoftë Allahu! E frikshme të dashur dhe të shtrenjtë! Ne në Islam thërrasim drejt asaj që natyra, të cilën Zoti i Gjithësisë e ka krijuar, të shtohet, të shumohet dhe të përzgjidhen besimtare të mira e besimtarë të mirë, në mënyrë që të krijojmë familje të shëndosha, në mënyrë që jeta të zhvillohet mbi bazat e dashurisë së Allahut dhe mbi bazat e më të mirës në këtë botë.

Dy argumente
dhe e përfundojmë dersin e kësaj dite.

E para, në lidhje me martesën, prej argumenteve të Madhërisë së Tij, është se ka krijuar nga njëri soj palën tjetër; e ka konsideruar krijimin e palës tjetër argument të Madhërisë së Tij.

Hz. Ademi ishte në xhenet, i vetëm dhe u mërzit. Zoti e dinte këtë, prandaj

4

krijoi për të nga lloji i tij gruan e tij. Në Kur'an thotë: "Ka krijuar për ju gratë që të gjeni prehje dhe qetësi në to". I lumi ai që gjen qetësi në gruan e tij dhe i ngrati ai që del nga shtëpia për shkak të gruas së tij..!? Dikush thotë: "O Zot ma zgjat ditën sa më shumë", sepse e di se kur të shkojë në shtëpi do të hyjë në një burg a në një "kamp internimi"! Zoti na ruajtë!

> Një falënderim të përzemërt për të gjithë ata deputetë, drejtues fetarë, institucione fetare e shoqërore, lëvizje shoqërore që ngrihen për të mbrojtur tabanin, për të mbrojtur pastërtinë, për të mbrojtur nderin dhe familjen. Patjetër, që zemrat tona e duart tona janë me ta.

Ai ka krijuar gruan për të qenë qetësi për burrin e saj, e jo të jetë shkak i rrënimit. Allahu (xh.sh) ka vendosur në lidhjen e burrit dhe gruas dashuri të madhe dhe mëshirë.

Prandaj, gjithsecili nga ne të shohë në marrëdhënien e tij me gruan e tij.

A gjen prehje në gruan e tij, a kënaqet kur e sheh, a është e pastër, a është e sjellshme, a është fisnike, a ka ato cilësi që i përmend Pejgamberi (a.s) e Kur'ani Famëlartë, a ka dashuri në mesin e tyre, a kanë mëshirë dhe dhembshuri për njëri-tjetrin? Nëse janë këto veçori, i lumi ai dhe e lumja ajo! Nëse nuk janë, nuk ka kush që bën derman!?

Dhe e fundit, krijimi, martesa, fëmijët, lindja e fëmijëve është rizk dhe rizkun e ka në dorë vetëm Allahu (xh.sh). Allahu (xh.sh) është Ai, i Cili urdhëron në suren Esh-Shura: "Allahut i takon pushteti i qiejve dhe i tokës! Mbreti i mbretërve! Ai krijon çfarë të dojë, i dhuron kujt të dojë vajza!" (Mashallah! Allahu (xh.sh) e ka begatuar vajzën dhe e ka begatuar atë familje ku ka vajza).

E ka nisur rrëfimin e rriskut të madh në martesë me vajzat. Ai i falë dhe i jep kujt të dojë vajza dhe i falë kujt të dojë djem. Dr. Nabulsi thotë: "E ka sjellë në trajtë të pashquar, se vajza dhe femra është e mbuluar dhe kjo është argument dhe thirrje drejt mbulesës, ndërsa djemtë i ka sjellë në trajtën e shquar, sepse djemtë dalin në jetë, punojnë, lodhen e sakrifikojnë."

Fëmijët ose i falë çift, binjakë, o djem, o vajza, o djalë e vajzë, kemi shumë raste dhe krejt i dimë ato. "E kujt të dojë, nuk i falë fëmijë". Është steril, është shterpë e nuk bëjnë fëmijë. Kanë shkuar tek mjeku, kanë shkuar këtu, atje. Nuk është rizk! Ky është caktimi i Allahut (xh.sh). Ai është i Plotëdijshëm dhe përcaktimi i Allahut është në dorën e Tij. Këtu del në pah forca e besimit dhe morali i besimit në Islam. Nuk ka nëna surrogate! Këto nuk hynë as te morali i besimit e as te morali i natyrës së pastër njerëzore. Të ka falur Zoti fëmijë, elhamdulilah! Nuk të ka falur, këtu mbyllet. *Nëna surrogate është e barasvlershme me imoralitetin, mos ta them një fjalë më të rëndë.*

I lutem Allahut (xh.sh), që deputetëve të parlamentit tonë t'ia ndriçojë mendjen dhe t'i ruajë nga devijimi! Jo çdo projektligj që hidhet në parlament, sidomos ato që prekin thelbin e tabanit tonë kombëtar, qytetar, njerëzor, moral, fetar; jo çdo thirrje e tillë duhet të kalohet. Përkundrazi duhet të refuzohet dhe duhet të ndalohet me të madhe.

Një falënderim të përzemërt për të gjithë ata deputetë, drejtues fetarë, institucione fetare e shoqërore, që ngrihen për të mbrojtur tabanin, pastërtinë, nderin dhe familjen. Patjetër, që zemrat tona e duart tona janë me ta!

I lutem Allahut (xh.sh) të na forcojë në këtë fé e të na bëjë prej atyre që dëgjojnë fjalën dhe veprojnë më të mirën e saj. Lutem të na dhurojë forcë dhe kurajo për të thënë të mirën, të bukurën dhe të drejtën pa ndrojtje, pa frikë dhe me bindjen se Allahu (xh.sh) ka për ta begatuar çdo frymë dhe çdo lëvizje tonë në këtë drejtim.

(Deri i xhumasë i mbajtur në xhaminë e "Dy Vajzave", më 24/5/2024)

Diktoi: **Siditë Hafizi**



Shejkh Muhamed El-Gazali
(1917-1996)

Refuzojmë tërësisht me tërë refuzimin e mundur, që të na thuhet: Bëjeni Islamin të kufizuar në namaz brenda xhamisë; Ose në anëtarët e familjes brenda shtëpisë!

Ateizmi kur veçohet me pushtetin, jashtë shtëpisë dhe jashtë xhamisë, nuk qëndron shumë gjatë, derisa të shkatërrojë shtëpinë dhe xhaminë së bashku.

Nuk gjykojmë për paralizim të gjysmës së fesë tonë dhe me vdekje të gjysmës tjetër.

Në botën islame, tani ka zëra, që thonë: Kufizojeni fenë në sjelljet individuale; Dhe, lëreni shoqërinë të lëvizë si të dojë!

Ne e dimë se, kush i fryn këto zëra dhe i mbron ata, të cilët i thonë!

E dimë qëllimin, që fshihet pas tyre; Ai është eliminimi absolut ndaj Islamit, si individ dhe si shoqëri, dhe ndaj Akides (Besimit) dhe Sheriatit së bashku!



Durim Kasemi
Imam, xhamia Parrucë

BESIMI DHE PYETJA!

Njohja e pozicionit të njeriut në këtë gjithësi - cilado që të jetë e vërteta e kësaj gjithësie - dhe e drejtimeve të rrugëtimit në të, është diçka që ngjall pyetje dhe nxit diskutim, vëzhgim e kërkim. Kjo zë mendjet e shumë njerëzve dhe zemrat e tyre. A thua vallë, kjo është një pyetje e dilemë serioze e cila meriton që njeriu të brengoset për të apo, kjo është diçka për të cilën nuk ia vlen të stresohemi e të humbasim kohë?

VESVESE RRETH TË FSHEHTAVE APO PËRPJEKJE PËR TË KUPTUAR?

Autorët e enciklopedisë britanike, në mesin e shekullit të njëzetë, publikuan 54 vëllime që përmbanin atë që e kishin quajtur "Librat më madhështorë të botës perëndimore"[1]. Këto ishin libra në filozofi, shkencat e natyrës, legjislacion dhe teologji. Tema më e gjerë në këtë enciklopedi ishte ajo që fliste rreth Zotit.

Kur u pyet filozofi Mortimer J. Adler, i cili ishte edhe njëri nga përpiluesit e kësaj enciklopedie dhe përzgjedhësit librave qysh nga koha e Greqisë së lashtë, se përse ishte përzgjedhur që tema fetare, të ishte më e madhja dhe më e gjëra në këtë enciklopedi, ai u përgjigj: "Sepse një sërë konsekuencash me ndikim në jetën dhe veprën e njeriut lidhen me theksimin e ekzistencës së Zotit apo mohimin e tij dhe kjo veçori nuk i takon asnjë çështje bazike tjetër"[2].

Njeriu është "qënie pyetëse", pyet sepse është krijuar që të lidhë gjërat e tashme me horizontet e largëta. Është formësuar të lidhë arsyet e motivet me përfundimet dhe urtësitë. Ai pyet sepse ana e jashtme e gjërave nuk e shuan etjen e tij të përhershme për të ditur se çfarë qëndron pas fasadës. Ai pyet sepse kërkon të kuptojë... Kuptimi për të është shpirt që nuk ngopet dhe thellësi e pafundmë...

Pyetja rreth ekzistencës materiale dhe lidhjes së saj me Zotin është derë e çdo pyetje me peshë që vjen pas saj.

Ateisti apo apateisti, mund të shqetësohen nga shqetësimi i tepërt i njerëzve rreth origjinës së ekzistencës, urtësisë së krijimit dhe fundit të përhershëm dhe mund të thonë: Ekzistenca siç e shohim ne, nuk është gjë tjetër, përveç materie dhe energji, atëherë përse duhet të kërkojmë për një shpjegim fillestar dhe një qëllim final?!

Kjo kundërshti e refuzon mahnitjen. Ky është gabimi i parë i mendjes dhe më i madhi, sepse çdo devijim intelektual, fillimet e tija, janë tek një devijim i vogël prej të vërtetës, e pastaj zgjerohet hendeku mes rrugës së drejtë dhe asaj të shtrembër dhe ateizmi nuk bën përjashtim këtu.

Po të vërehen argumentet e besimit, të cilët janë të shumtë e pastaj të kundrohet gafleti i ateistit lidhur me to, do arrihet në përfundimin se ateisti mendon se gjithësi me çka ka në të, nuk është një e mundur prej të mundurave, por është diçka ekzistente dhe kaq; është diçka që nuk kërkon meditim rreth tij dhe që nuk nxit parehati ne ndërgjegjen e njeriut.

Ateisti, i cili refuzon mahnitjen, është i bindur me atë që i tregon fasada, ai nuk pyet se përse ekziston kjo gjithësi? Përse është në këtë formë e në këtë rend? Nga vjen kjo rregullsi? Përse është kjo përbërje?

Ai niset nga pyetja: Nëse Zoti ekziston, atëherë detyrimisht gjithësia duhet të jetë në formën më të mirë të përsosmërisë materiale dhe virtyteve; pa mangësi, pa dhimbje, pa të nesërme, pa qëllim...

Çdo gjë rreth njeriut dhe në të është e plotë dhe e përsosur. Ai vetëm duhet të marrë e të ngopet me to. Ekzistenca nuk është krijuar vetëm se për t'i përmbushur dëshirat njeriut dhe asgjë nuk qëndron pas saj! Nga këtu fillon çalimi dhe rrëshqitjet pasojnë njëra-tjetrën.

I MENÇURI NGA KU E FILLON? NGA ZEROJA?! NGA ASGJËJA?!

Për të pyetur: Përse ekziston kjo që është? Nuk e fillon nga imazhi iluzionarë i Zotit dhe qëllimeve e planeve të Tij në gjithësi.

Mendja niset nga një e vërtetë fillestare të thjeshtë, e cila është: E gjithë ekzistenca materiale është ngacmuese, kërkon shpjegim...

Si është gjendur?! Përse është kështu në këtë formë?! Qielli blu i hijshëm, lulja aromëmirë, detet e pasura me lloje të çuditshme jete, luginat e stërmbushura me prehje e qetësi... e gjithë kjo është ngacmuese dhe nxit mahnitje. Mahnitja më e madhe është tek diçka më vogël, se këto që përmendëm, ekzistenca e ekzistencës, vetja jote, mbi ty dhe poshtë teje, përse ekziston ekzistenca, përse nuk ka pllakosur asgjëja!?


Ekzistenca jonë është mrekulli, por mendja e zhytur dhe e familjarizuar me imazhet e objektet nuk mund ta tejkalojë momentin e përjetimit të ekzistencës për të vështruar e soditur në motivet e ekzistencës së saj.

1. Great Books of the Western World.

2. Ravi Zacharias,The real face of atheism f.20.



JONUZ TAFILAJ DHE FJALORTHI I TIJ I GJUHËS SHQIPE I VITIT 1931



Xhahid Bushati, *shkrimtar*

Vjetin e kaluem ishe emnuem prej Këshiellit të Komunitetit Musliman si mësues i përkohshëm i gjuhës Shqipe në nji kurs të Medresës së Naltë. Gjatë mësimevet e sidomos tue u marrë me ushtrime lezimi vrrejta nji gjâ: se nëzânësit ndesheshin në nji vështërsí të pá-shpërblyeshme në kuptim të shum fjalëve të hueja të përdoruna në Shqipe prej shkrimtarëvet...

Duke gjurmuar në arkiva biblioteke, u ndesha me një emër të panjohur për mua, dhe ai quhej Jonuz apo Junuz Tafilaj (Shkodër, 13.06.1892 - nëntor 1976). U nda nga jeta në moshën 84-vjeçare. Tani në maj të vitit 2024 më shfaqet ky emër, i cili ka ndërruar jetë 48-vjet më parë, dhe me një kontribut të çmueshëm, pothuajse i papërmendur dhe i “strehuar” diku “djerrinave të kohës”, - siç thotë në një libër të tij publicistik gazetari i talentuar Frano Kulli.

Kush është në të vërtetë Jonuz Tafilaj? Gjurmimet na thonë, se ka qenë veprimtar i çështjes kombëtare, vullnetar në Luftën e Koplikut, publicist dhe orientalist me emër.

U lind në Shkodër më 13 qershor 1892. Filloren dhe të mesmen (Shkollën ushtarake “Ruzhdije”) i kreu në Vendlindje. Gjatë pushtimit dhe administrimit Austro-Hungarez, Jonuzin e burgosën, sepse ishte një nga nismëtarët e demonstratës në mbrojtje të “Xhamisë Plakë”, në lagjen “Zdralej”, në Shkodër. Jonuz Tafilaj, më 1919, është ndër themeluesit e Shoqërisë “Vëllazënija” së bashku me Hilë Mosin dhe Kel Marubin.

Më pas Tafilaj bëhet sekretar i kësaj Shoqërie. Kontribuoi në radhët e të përkohshmes “Agimi”, organ i “Vëllazënisë”, me artikuj të ndryshëm. Veçanërisht shquhen shkrimet me trajtesa të thella, si për shkrimtarin Namik Qemal dhe për Oson e Falltores, etj. Të mos harrojmë se Tafilaj ishte dhe një aktor amator i talentuar. Interpretoi dhe u dallua në komedinë “Shërbëtori i dy zotnive”, si dhe në pjesën “Erminia e vorfën”; pjesë që u vunë në skenë nga shoqëria. Më pas u bë anëtar i shoqërisë “Bashkimi” themeluar nga Avni Rustemi. Më 1920 mori armët dhe shkoi për të luftuar në Luftën e Koplikut. Shënojmë se, Tafilaj ishte dhe sekretar nderi në Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosvës”.

Përkrahte opozitën e viteve 1920-’24 drejtuar nga patrioti Luigj Gurakuqi dhe Sulçe beg Bushati. U radhit ndër anëtarët e shoqërisë “Bashkimi” që u pajisën me armë pas Lëvizjes së Qershorit. Më 1931 botoi “Fjalorth shqip” nga shtypshkronja “Shkodra”, në Tiranë. Më 1936 botoi tek e përkohshmja “Afrimi” e Vlorës shkrimin Gjuha e jonë e martirizueme nga shkrimtarët e saj me pseudonimin J. Jalifati. Radhitet ndër botuesit e të përkohshmes “Përpjekja shqiptare”. Më 1937 është sekretar i përgjithshëm i Kryqit të Kuq Shqiptar.


Pas 1944, u mor në shërbim prej Institutit të Shkencave si përkthyes, më pas vijoi i tillë në Arkivin e Shtetit. Në mars të 1945, i caktuar nga ministri i shtypit, propagandës dhe kulturës popullore Sejfulla Malëshova, u ngarkua të kontrollonte librat, dorëshkrimet dhe dokumentet e tjera që ndodheshin në bibliotekën e Syrja dhe Eqrem Vlorës. Pas kontrollit dhe raportimit që kreu me këtë detyrë, biblioteka private e Vlorajve u shtetëzua.

Së bashku me Myqerem Janinën dhe Eleni Dukën përkthyen një pjesë të mirë të fermaneve të Perandorisë Osmane, duke qenë ndër kontributorët madhorë në përkthimin e katalogimin e dokumenteve osmane. Ka përkthyer gjithashtu vëllimin Historia e pashallarëve shqiptarë në Perandorinë Osmane të Syrja bej Vlorës nga osmanishtja. Përktheu romanin “Jaban - I huej” të shkrimtarit turk Yakup Kadri Karaosmanoğlu, botuar më 1943; si dhe romanin “Mësuesi idealist” të shkrimtarit bullgar Grigori Petroff, botuar më 1944.

E përmendëm më lart, se në vitin 1931 botoi “Fjalorth shqip” nga shtypshkronja “Shkodra”, në Tiranë. Duke u njohur me këtë vepër dhe vlerat e saj; autori Jonuz Tafilaj “Fjalorth-in” e tij e shoqëroi me një parathënie të titulluar “ Dy fjalë”. Atëhere Tafilaj ishte 38-vjeç.

Po njihemi me parathënien e autorit, të titulluar “Dy fjalë”.

Vëllimi fort i vogël i këtij fjaluer as bán as meriton me vuem në krye të tij nji parathanie gadi si të zakonshme. Prá nepër këto rreshta nuk ndjek tjetër qillim, veçse të rrëfej se si më leu idhéja me pirpiluem këtë fjaluer.



Nri 5. Shkodër Shtatuer 1919. Vjet' e I.

AGIMI

Periodikë letrare e përmuejshme.

Organ i Shoqnisë "VËLLAZNIJA,,

Dreitues: D. KRISTO FLOQI.

Vrojtime.

Artikuj e shkrime pranohen, por se vetëm mbi literaturë, të zgjedhun, të plotë e të dobishëm.

Dorëshkrimet pranohen ose jo, nuk kthehen prapë.

Për reklama, zadhânje e tjera shkrime vehtjake merruni vesht me Dreitimin.

DREJTIMI PERIODIKA "AGIMI,, SHKODËR.

Pajtime.

Në Shqypni.	Për jashta.
P. 3 muej F. 3.	P. 3 muej F. 4.
P. 6 muej F. 6.	P. 6 muej F. 8.
P. 1 vjetë F. 10.	P. 1 vjet F. 14.

Pajtimet çohen te Ilogaritar' i Shoqnisë z. Ali Borshi Shkodër.

Se i cili numer kushton Frank 1.00

PERMBAJTJA E LÂNDËS

Për nji kundërshtim	proj "Agimi,,	Argtim theatruer	proj Critices
Shtjegrtime gjuhe	» M. L.	Lodra	» M. Krimshit
Tempulli' i Dodonës	» Kr. Floqit	Andej e Këndej	» J. Tafilaj
Historí e Ilirvet	» Hil Mosit	Fjalë popullore	» O. Rusbdi
Asaj	» H. Gjylbegaj	Shkol e shko	» Mushkaja

Shtypshkroja «Nikaj» Shkodër 1919

Vjetin e kaluem ishe emnuem prej Këshiellit të Komunitetit Musliman si mësues i përkohshëm i gjuhës Shqipe në nji kurs të Medresës së Naltë. Gjatë mësimevet e sidomos tue u marrë me ushtrime lezimi vrrejta nji gjâ: se nëzânësit ndesheshin në nji vështërsí të pá-shpërblyeshme në kuptim të shum fjalëve të hueja të përdoruna në Shqipe prej shkrimtarëvet. Atëherë më hyni në krye me i u bám atyne nji nderë të vogël. Mblodha fjalët e hueja qi muejta me tokue aty-këtû ndër libra e fletore ‘dhe i radhova, për sá më qe e mundun, nën nji rènd alfabetik. E kshtû leu ky fjalorëth.

Mirë po ‘dhe un n’ anë tjetër u perballova me nji pêngim: Me mungesen e të hollave për t’a botuem fjalorin. M’erdhi në ndimë dhe më siguroj shtypjen e fjalorit Firma “Taraboshi” në Shkodër, e cila perpiqet me flijet e saja jo vetëm në lamen ekonomike për t’ i a ndryshuem fytyren e zbét por madhtore të Shkodrës, por orvatet me dhanë perkrahjen e duhun edhe në fushen intelektuale, si e provoj këtë shteg me vepren e saj bâmirse.

Prá, në se nëzanësat e Medresës së Naltë a po ndokush tjetër ka me korrë ndonji dobí sado të vogël prej këtij fjaluer, i tanë meritimi në këtë rasë âsht i Firmës në fjalë.

Kjo vepër e “Taraboshi” - t të jetë shembëll për pasanikët e qyteti të Shkodrës!

Tiranë, me 10 Shtatuer 1930

J. Tafilaj

* * *

Ky Fjalorth edhe pse i vogël është një enciklopedi, ku ndiçojnë fuqishëm kultura e modestia, argumenti dhe realiteti, dashuria dhe ndihmëtari, si dhe gjeneza, ku Jonuz Tafilaj lindi, e, ajo quhet Shkodër. Kujtojeni edhe një herë përcaktimin dhe vizionin për të: “... për t’ i a ndryshuem fytyren e zbét por madhtore të Shkodrës, ...”.

E shfletoj me kujdes çdo fletë të Fjalorthit; ndalem te shpjegimi dhe analiza linguistike e çdo fjale dhe mendohem... Po, po mendohem për rrugëtimin, sprovat, vështirësitë e autorit Jonuz Tafilaj për të kërkuar në vend të fjalës së huaj gjegjësen me brumë të shqipes.

Është e pamundur të mos vëresh: pasionin, literaturën e gjerë të shfrytëzuar... etj. Për gjurmët që nuk treten dhe kulturën që ka lënë shenja jete në çdo fjalë të analizuar, Jonuz Tafilaj duhet lavdëruar dhe përgëzuar. Sepse, në panteonin e madh të Fjalorëve, diku si një gur i çmuar dritëson në dimensionet e veta edhe ky Fjalorthi i vogël i Gjuhës shqipe me autor Jonuz Tafilaj.

PSE QUHET ÇLIRIMTAR I KOSTANDINOPOJËS SULLTAN MEHMETI (FATIHU) - 29 MAJ 1453

Fermani i Sulltanit ku deklaronte dhe betohej në Zot se nuk do tu prekeshin as pasuritë, as kishat dhe as nderi i njerëzve ... e gëzoi shume popullin e shkërmoqur.

Azem Kovaçi

Kushdo ne rrethet akademike, dinjitoz, i balancuar akademikisht dhe i çliruar islamofobikisht..e pohon se

...KOSTANDINOPOJA ..me dekada ne vazhdim para ardhjes se Osmaneve ..ishte e robëruar, e shkatërruar, përdhunuar, paralizuar nga kryqëzatat dhe kryqëzorët, te cilat ishin te orkestruara nga Evropa perëndimore dhe papati.

Këta fushata kryqëzatash qe zbarkonin dhe qëndronin në Kostandinopojë e kishin gjunjëzuar perandorinë dhe kryeqytetin e Bizantit. Sepse kisha e lindjes (ortodoksia) nuk pajtohet tejpërtej me agjendat e papatit...

Kur Sulltan Mehmeti e mori qytetin me 29 Maj 1453, gjeti një Kostandinopojë me popull të lodhur dhe qytet të këputur.

Fermani i Sulltanit ku deklaronte dhe betohej në Zot se nuk do tu prekeshin as pasuritë, as kishat dhe as nderi i njerëzve ... e gëzoi shume popullin e shkërmoqur.

Çfarë i gëzoi edhe më tej njerëzit e Kostandinopojës ishte po ashtu edhe çlirimi nga taksat brutale qe Kisha dhe perandori merrnin nga populli i thjeshtë.

Xhizja e Sulltanit ishte modeste ne krahasim me taksat e mëparshme dhe me këtë xhizje ushtria muslimane u garantonte siguri/mbrojtje.

Sulltan Mehmet Fatihu/Çliruesi po ashtu i garantoi kishës autoqefale ortodokse siguri/mbrojtje dhe respekt. Një gjë, që edhe sot e kësaj dite, dihet që qendra kryesore e ortodoksisë gjendet në Stamboll - ky një testament më vete që indikon tolerancën e Sulltanit dhe muslimanëve ndër shekuj.

Kushdo që aludon se Sulltani dhe ushtria e tij plaçkitën dhe përdhunuan, gënjejnë dhe manipulojnë, janë të verbuar nga urrejtja islamofobe. Ushtritë muslimane kanë qëndruar gjithmonë më lart se të tyret në të gjitha nivelet njerëzore, humane dhe luftarake. Ky është fakt historik i pakontestueshëm.

29 Maj 2024



VËLLAZËRIA NË ISLAM



Naim Drijaj
Imam, xhamia Parrucë

Këtë temë do ta ndaj në tri pjesë.

Pjesa e parë ka të bëjë me kuptimin e drejtë të vëllazërisë.

ÇFARË KUPTOJMË KUR THEMI QË MUSLIMANËT JANË VËLLEZËR?

1. Vëllazëria islame dhe lidhja ndërmjet muslimanëve është reflektim i natyrshëm i besimit tonë në Allahun (xh.sh). Sa më i fortë që është besimi, aq më e fortë është edhe lidhja mes nesh. Në këtë botë për disa njerëz ne sakrifikojmë çdo gjë, ndërsa për disa të tjerë nuk sakrifikojmë asgjë. Pse? Për shkak të lidhjes që ne kemi me ato.

2. Ne si muslimanë kemi ardhur në këtë botë që të realizojmë një mision shumë të rëndësishëm, ku prej tij varet shpëtimi dhe dënimi ynë. Aq sa e kemi kuptuar misionin, aq do ta kuptojmë edhe rëndësinë e atyre, që janë bashkudhëtarët tanë në këtë mision. Shumë gjëra në Islam nuk kryhen në mënyrë individuale, por duhet kryer në mënyrë kolektive. P.sh namazi i xhumasë, etj.

Seid ibn Musejib nga tabiinët në një moshë shumë të thyer (80 apo 90 vjeçare) ishte i verbër dhe kishte dëgjuar se muslimanët po shkonin në luftë. Ai u kërkoi fëmijëve të tij që ta përgatisnin që ai të merrte pjesë në luftë. Fëmijët i thanë: "O babai ynë çfarë mund të bësh ti në luftë? Ti nuk ke mundësi të kontribuosh për arsye të moshës dhe gjendjes që ke". Ai përsëri u tha fëmijëve të tij që ta bënin gati duke këmbëngulur që të shkonte. Kur Seid ibn Musejib ka dalë në radhët e muslimanëve, ato i kanë thënë, që më mirë të qëndronte në shtëpinë e tij. Ai u përgjigj atyre duke u thënë: "Unë nuk mund të gjuaj shigjeta e as të kacafytem me armikun por unë mund ta shtoj numrin e muslimanëve. Kur ata të shohin nga larg nuk do ta kuptojnë që unë jam plak apo i verbër, por ata do të shohin një musliman më shumë dhe kjo për mua është e mjaftueshme.

Prandaj çdo kush ka mundësi të bëjë diçka dhe nuk duhet nënçmuar puna e askujt. Të parët tanë kur nuk kanë pasur mundësi të kontribuojnë me pasuri apo me diturinë e tyre atëherë ata kanë kontribuar me devotshmërinë e tyre.

Një nga të parët tanë, në moshë të vjetër, i është bashkangjitur ushtrisë për në luftë. Kur ata kanë arritur në fushë-betejë me armikun, ai ka dalë përpara komandantëve të ushtrisë dhe u ka thënë: "Sot me lejen e Allahu ju garantoj se nuk do të mposhtemi, sepse unë kam investuar për këtë luftë tek Allahu me 4.000 hatme të Kur'anit. Shpresoj që kam një derë të hapur tek Allahu që po iu luta Ai do të na ndihmojë!"

Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Pjesë e madhërimit të Allahut është të nderosh plakun musliman".[1] Në një hadith tjetër thuhet: "Me të vërtetë, Allahu e ndihmon këtë ymet për shkak të të dobëtëve prej tyre, për lutjet e tyre, namazin e tyre dhe sinqeritetin e tyre!"[2]

3. Allahu (xh.sh) kur përmend lidhjen mes muslimanëve na emërton me një emër: "Me të vërtetë besimtarët janë vëllezër!"[3] Allahu i Lartësuar nuk thotë bëhuni vëllezër apo konsiderojeni njëri-tjetrin vëllezër, por na informon se ne jemi vëllezër. Pra, nuk është çështje që mund të zgjedhësh, Ai paraprakisht na ka bërë vëllezër me njëri-tjetrin. Termi vëlla është term i madh dhe ka domethënie të madhe. Ai është dy llojesh:

1. Vëlla nga gjaku (nga fisi), siç ka thënë Allahu (xh.sh) për Hudin (a.s): "Edhe tek Adi dërguam vëllanë e tyre, Hudin"[4], Hudi (a.s) ishte vëllai i tyre nga ana e gjakut.

2. Vëlla nga feja, kur dy persona i përkasin të njëjtës fe ata janë vëllezër edhe nëse nuk janë vëllezër nga nëna dhe babai apo nga fisi. Pra, kemi vëllazëri nga gjaku dhe nga feja dhe ndaj të dy palëve muslimani ka obligime. Vëllazëria nga feja gjithsesi është më e fortë dhe më e frytshme për dynja dhe për ahiret. Çdo lidhje që nuk ngrihet mbi besimin është lidhje e përkohshme e cila mbaron me mbarimin e shkakut dhe qëllimit mbi të cilin është krijuar.

Po i kuptuam këto që thamë më sipër atëherë çfarë do të ndodhë me ne?

Pjesa e dytë ka të bëjë me reflektimin praktik të kësaj vëllazërie në jetën e përditshme.

Barometri i brendshëm që sinjalizon që ne jemi duke shkuar drejtë unitetit e vëllazërisë së mirëfilltë (drejtë kuptimit të drejtë të vëllazërisë) është:

1. Përjetimi i ëmbëlsisë së adhurimeve. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Tri gjëra, nëse gjenden tek njeriu, do ta shijojë ëmbëlsinë e vërtetë të besimit; të jenë Allahu dhe i Dërguari i tij më të dashur te ai se gjithçka tjetër, ta dojë një njeri tjetër për hatër të Allahut dhe të urrejë të kthehet në mosbesim ashtu siç urren ta hedhin në zjarr!"[5] Nëse duhemi me njëri-tjetrin atëherë edhe adhurimet tona do të marrin shije.

> "Sot me lejen e Allahu ju garantoj se nuk do të mposhtemi, sepse unë kam investuar për këtë luftë tek Allahu me 4.000 hatme të Kur'anit. Shpresoj që kam një derë të hapur tek Allahu që po iu luta Ai do të na ndihmojë!"

2. Do të na dojë Allahu (xh.sh). Për këtë kemi shumë argumente dhe sa për ilustrim po përmend hadithin kudsij: "Është vërtetuar dashuria Ime ndaj atyre që duhen mes vete, ndaj atyre që vizitojnë njëri-tjetrin, ndaj atyre që ndihmojnë njëri-tjetrin, ndaj atyre që nuk i shkëpusin lidhjet mes tyre (interesohen për njëri-tjetrin)!"[6]

1. Ebu Daudi, 4843. Sahihul-Xhamii, 2199.
2. Silsiletu-Sahihah, 2/409.
3. Kur'El-Huxhurat, 10.
4. El-A'raf, 65.
5. Buhariu, 16; Muslimi, 43.
6. Ahmedi, 19438, 19662; Hakimi, 4/169; Ibn Hibani, 577; Bejhakiu në "Shuab el-Iman", 6/483. Hakimi ka thënë: "Senedi i tij është sahih sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit", edhe pse ata të dy nuk e kanë transmetuar.

ÇFARË NDODHË NËSE NE NA DO ALLAHU?

Ibn Kajimi thotë: Kur Allahu e do një njeri tek ai ndodhin tri gjëra:

1. Largimi i kompleksve. Ai lirohet nga komplekset dhe e rëndësishme për të është të praktikojë atë që Allahu ka thënë. Ai nuk e ngarkon veten me komplekse të tilla si: dikush më pa, më foli apo dikush më shkroi por e rëndësishme për të është fitimi i kënaqësisë së Allahut.

2. Ëmbëlsia e adhurimeve.

3. Tejkalimi me durim i sprovave dhe sfidave.

Pjesa e tretë ka të bëjë me gjërat që e ushqejnë këtë vëllazëri.

Si mund të arrihen këto që u përmendën më lart? Ato që na ndihmojnë për t'i arritur këto që thamë janë:

1. Mendimi i mirë për muslimanët.

Çfarë do të thotë të kesh mendim të mirë për muslimanët?

Dijetarët në lidhje me mendimin e mirë për muslimanët kanë pasur për qëllim hadithin e Pejgamberit (a.s) i cili ka thënë: "Prej Islamit të mirë të një njeriu është të lërë atë që nuk i intereson!"[7] Besimtari i mirë duhet të heq dorë nga gjithçka që nuk i intereson. Në lidhje me këtë hadith Imam Neveviu ka thënë: "Kushdo që merret me atë që nuk i përket do t'i ikë ajo që i përket!"

2. Mbyllja hermetike e dyerve të thashethemeve, bartjes së fjalëve, etj. Këto e dëmtojnë seriozisht kështjellën e vëllazërisë islame. Një njeri erdhi tek Hasan El-Basriu (Allahu e mëshiroftë) dhe i tha:"Filani të ka sharë dhe ka folur keq për ty!"Atëherë Hasan El-Basriu ia ktheu atij duke i thënë: "Po a nuk gjeti shejtani ndonjë postier tjetër për ketë përveç teje?" Mos u bëj postier i shejtanit!

3. Ndihma reciproke mes muslimanëve. Të ndihmojmë njëri-tjetrin, me aq sa kemi mundësi.

Ali ibn Husejn, i njohur si Zejnul Abidin (Allahu e mëshiroftë), e ngarkonte ushqimin në shpinë dhe gjatë natës ua shpërndante të varfërve në Medine. Banorët e Medines ushqeheshin dhe nuk e dinin se prej nga u vinte ushqimi. Kur ndërroi jetë Ali ibn Husejn, u ndal edhe shpërndarja e ushqimit. Kur e lanë xhenazen e tij, i vërejtën shenjat e thasëve, që i kishte bartur me ushqime për tek shtëpitë e të varfërve. Kështu ata e kuptuan se ai kishte qenë ai që u shpërndante ushqimin natën të varfërve nëpër Medine.[8]

Një ditë Ali ibn Husejn ka hyrë tek një musliman dhe e ka gjetur duke qarë. Ai i ka thënë: Çfarë të ka bërë që të qash o vëlla? Ai i është përgjigjur: Borxhet (për nevojë) e mëdha o vëlla. Me vjen turp të dal për tu falur në xhami dhe më ka ikur namazi me xhematë për shkak të borxheve, që ua kam njerëzve që vinë në xhami. Ali ibn Husejni i ka thënë: Janë të kryera borxhet e tua. Borxhliu i tha: "Ti nuk e di se sa janë borxhet e mia, pyet njëherë e pastaj thuaj që u lanë!". Zejnul Abidini i tha: "Nuk është me rëndësi se sa janë borxhet e tua por më rëndësi është se një lot në faqen tënde është më e shtrenjtë për mua se sa krejt bota!"

Allahu (xh.sh) ka thënë: "Kush është ai që do t'i jap Allahut një hua të mirë, që Ai t'ia shtojë atë shumëfish?"[9]

Një ditë një musliman ka trokitur në derën e një dijetari dhe i ka thënë: "Jam në hall, a ke mundësi që të me ndihmosh me diçka?" Dijetari e ka ndihmuar dhe i ka thënë: "Allahu të shpërbleftë me të mira!" Nevojtari i ka thënë: "Allahu të shpërbleftë ty me të mira sepse ti më ndihmove!" Dijetari i ka thënë: "Allahu të shpërbleftë ty, ngase ty do të kishte ndihmuar dikush, por elhamdulilah, që Allahu më zgjodhi mua për të ndihmuar ty, e jo dike tjetër!"

Nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: "Allahu do të thotë në Ditën e Gjykimit: O biri i Ademit, Unë rashë i sëmurë, e ti nuk më vizitove! Njeriu do të thotë: O Zot, si mundem unë të vizitoj Ty, kur Ti je Zoti i botëve? Allahu do të thotë: A nuk e dije se një ndër robërit e mi ra i sëmurë, e ti nuk e vizitove? Dije pra, se sikur ta vizitoje do të më gjeje tek ai! O biri i Ademit, Unë të kërkova ushqim, e ti nuk më ushqeve! Njeriu do të thotë: O Zot, si mundem të të ushqej unë Ty, kur Ti je Zoti i botëve? Allahu do t'i thotë: A nuk e dije ti se një ndër robërit e mi të kërkoi ushqim, e ti nuk i dhe? Dije pra, se sikur ta ushqeje, do ta gjeje (shpërblimin e ushqimit) tek Unë! O biri i Ademit, Unë të kërkova ujë, e ti nuk më dhe! Njeriu do të thotë: O Zot, si mundem unë të të jap ujë, kur Ti je Zoti i botëve? Allahu do të thotë: A nuk e dije ti kur të kërkoi një ndër robërit e mi ujë, e ti nuk i dhe? Dije pra, se nëse do t'i jepje ujë, do ta gjeje (shpërblimin e asaj vepre) tek Unë![10]

7. Tirmidhiu, 2317; Ibn Maxhe, 3976.
8. Sijer Ealam en-Nubela, 4/393.
9. Kur'ani, El-Bekare, 245.
10. Muslimi, 2569.

"NA SHQYPTARËT E KËTIJ VILAJETI I FALENA NDERES MA S'PARIT GJEVERIS T'STAMBOLLËS..."

Xhafer Sadiku

GAZETA "BASHKIMI",
SHKODER 27 SHKURT 1910
(Nga kryeartikulli i Ndoc Çobës)

"...M'një za pra, na shqyptarët e këtij vilajeti i falena nderes ma s'parit Gjeveris t'Stambollës për mirësi qi, për ditë e ma tepër po asht tui diftue për ne t'birt Shqyptaris, tui na dhanë nji liri t'plotë n'shvillim


Viti i I. Tiranë e Premte 29 Shkurt 1924 5 K.v. copa Nr. 32.
Bashkimi
Del dy herë në javë
28 VJESHT' e TRETE

t'gjuhës s'onë, e s'dytit atyne deputetave shqyptar qi, tui luftue trimnisht e me nji zellë t'vërtetë t'atmijet, kanë ditë me i krye dishiriet e t'ma shumicës e shqyptarëve; dishirë t'pështetuna mbi t'lypunit e shkrimit të gjuhës shqype me germa latinishte, sikurë e ka da edhe Kuvendi gjuhësor qi tash vonë a ba n'Manastir.

Me nji mënyrë të posaçme i falena nderes t'Përshëndritshmit Esat pashës Toptani qi, tui u përkujdesë kaq fort për lulëzim t'gjuhës shqype, ka dashtë, sikurse gegë qi asht, me i përtri nji za t'mirë Gegnisë marë, e cila, deri sot, ka pasë metë fort mrapa prej Toskërisë për atmi e dituni!"

HABEI
PROVINCË E REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS

Habei (Hebei) është një provincë në Kinën e Veriut që shtrihet në veri të Lumit të Verdhë. Kjo provincë kufizohet me Rajonin Autonom të Mongolisë së Brendshme në veri, me provincat Liaoning në verilindje, Shandong në juglindje, Henan në jug dhe Shansi në perëndim. Në brendësi të provincës Habei ndodhen qytet-komunat autonome Pekin dhe Tianxhin. Brigjet lindore të provincës Habei lagen nga ujërat e detit Bo Hai.

Habei ka një sipërfaqe prej 188,800 km2 dhe është provinca e gjashtë më e populluar e Kinës, me një popullsi prej 73.93 million banorësh (2023).

Shixhiazhuang është kryeqyteti i provincës.

GJEOGRAFIA

Provinca Habei përbëhet nga dy pjesë kryesore pothuajse të barabarta: pjesa veriore e Rrafshinës së Kinës së Veriut, dhe vargmalet përgjatë kufijve veriorë dhe perëndimorë. E para nganjëherë quhet Rrafshina e Habeit. Ajo është e formuar kryesisht nga depozitat aluviale të pesë degëve kryesore të sistemit të lumit Hai, të cilat pasi takohen, rrjedhin nga ana e qytetit Tianxhin për në det.

Rrafshina e Habeit zbret ngadalë nga perëndimi në lindje, dhe kufizohet nga malet Jan në veri, malet Taihang në perëndim dhe ato Bo Hai në lindje. Në bazat e tyre malet kanë një varg tokash me sedimente të sjella nga lumenjtë. Ky brez i brendshëm toke i rrafshinës së Habeit është përgjithësisht i drenazhuar mirë.

Malet Jan formojnë skajin verior të rrafshinës së Kinës Veriore, duke i shfaqur udhëtarit para syve një det të pafund malesh me maja të rrumbullakosura, që arrijnë mesatarisht në 1.500 metra lartësi mbi nivelin e detit. Muri i Madh i Kinës ecën në mënyrë zigzage përgjatë majave të tyre. Përtej këtyre maleve, nga pjesa më veriore e provincës Habei e deri në Mongoli, shtrihet Rrafshnalta Mongole. Kjo pjesë e Habeit u përfshi në provincë në vitin 1952, kur kufijtë e Habeit u zgjeruan për herë të parë përtej rrafshinës së Kinës Veriore. Skaji i rrafshnaltës ka një lartësi mesatare prej 1,200 deri në 1,500 metra mbi nivelin e detit dhe është një zonë e thyer dhe jo e përshtatshme për vendbanim njerëzor. Midis maleve Jan ndodhen fusha të mëdha, të kultivuara dhe të banuara. Nga malet veriore nxirren qymyri dhe hekuri.

Në perëndim të Rrafshinës së Kinës së Veriut shtrihet vargmali i lartë verijug Taihang, që e ndan Rrafshinën Habei nga Rrafshnalta Shansi. Maja e tij më e lartë ngrihet në mbi 2,750 metra. Gama përshkohet nga një sërë përrenjsh perëndim-lindje, luginat e ngushta të të cilëve ("Tetë Grykat' e famshme të Taihangut) përbëjnë rrugët e autostradave dhe hekurudhave midis Rrafshinës së Habeit dhe Rrafshnaltës Shansi.



KLIMA

Provinca Habei ka një klimë të butë kontinentale musone. Shumica e zonave kanë katër stinë të dallueshme. Temperatura mesatare në Janar është nën 3°C, dhe temperatura mesatare në Korrik është ndërmjet 18°C dhe 27°C. Reshjet mesatare vjetore janë 484.5 mm, me më shumë reshje në juglindje dhe më pak në veriperëndim.

EKONOMIA

Provinca Habei është një nga rajonet kryesore prodhuese të drithit dhe pambukut në Kinë. Atje kultivohen gruri, misri, kaoliang (një lloj melekuqi), meli, patatet, pambuku, farërat vajore, kërpi, panxhari, duhani, etj.

Rrafshnalta Zhangbei në veri të Murit të Madh, është një zonë baritore, e famshme për rritjen e kuajve. Liqeni Baijang është mjaft i rëndësishëm për prodhimin e peshkut të ujërave të ëmbla. Periferia e qyteteve të mëdha ka pasur një zhvillim të konsiderueshëm të akuakulturës së ujërave të ëmbla (peshqve dhe karkalecave) dhe mbarështimit të blegtorisë dhe pularisë. Çinhuangdao i Habeit është një qendër e peshkimit detar.

Habei shtrihet në zemër të një prej dy rajoneve kryesore industriale në Kinë. Provinca zhvilloi një bazë industriale modeste që nga fundi i shekullit të 19-të e tutje, kryesisht atë të qymyrit, hekurit, tekstileve dhe zejtarisë indigjene. Gjatë viteve 1950 ndodhi një zgjerim i jashtëzakonshëm industrial dhe u zhvilluan me shpejtësi industria e minierave të qymyrit, industria e hekurit dhe e çelikut.

Në vitet 1960, shfaqja e fushave të naftës Huabei e bëri Habein një prodhues të madh nafte. Në vitin 1983 në Kinë hyri në funksionim fusha e parë e naftës në pjesën jugore të fushës së naftës Dagang, në bregdetin Bo Hai, duke prodhuar sasi të konsiderueshme nafte dhe gazi natyror. Përveç kësaj, një fushë e re e madhe nafte, pjesërisht në det të hapur, u zbulua në afërsi përgjatë bregut të detit Bo Hai në fillim të shekullit të 21-të.

Këto industri u bënë baza e rajonit industrial Pekin-Tianxhin, qendra industriale më e madhe dhe më e rëndësishme në Kinën e Veriut. Prodhimi industrial ka përparuar dhe është zgjeruar më tej duke përfshirë produkte të rëndësishme si çimentoja, pajisjet bujqësore dhe plehrat. Industritë e lehta në provincë përfshijnë prodhimin e tekstilit dhe qeramikës, përpunimin e ushqimit, dhe mullirin e letrës e të miellit. Tianxhin, qyteti i dytë më i madh në rajon, është qendra kryesore industriale dhe tregtare e Kinës së Veriut. Qytete të tjera të mëdha industriale në provincë përfshijnë qytetin Tangshan dhe Çinhuangdao në lindje, Baoding në pjesën qendrore, Shixhiazhuang në perëndim, dhe Handan në jug.


Kryeqyteti, Shixhiazhuang


GJUHA

Njerëzit në Habei flasin dialekte të mandarinit. Përgjatë kufirit perëndimor me provincën Shansi, fliten dialekte që janë pjesë e degës gjuhësore Xhin (Jin), një nënndarje e gjuhës kineze. Në përgjithësi, dialektet e Habeit janë të ngjashme me dialektin e Pekinit, i cili përbën bazën për gjuhën kineze standarde dhe gjuhën zyrtare të kombit. Megjithatë, ka edhe disa ndryshime të dallueshme, siç është shqiptimi i disa fjalëve duke futur rrokje shtesë në to.

FEJA

Fetë mbizotëruese në Habei janë fetë popullore kineze, traditat taoiste dhe budizmi kinez. Sipas sondazheve të kryera në vitet 2007 dhe 2009, 5.52% e popullsisë besojnë dhe janë të përfshirë në nderimin e paraardhësve, 3,05% identifikohen si të krishterë që i përkasin kryesisht kishës katolike, dhe që nga viti 2010, muslimanët përbëjnë 0,82% të popullsisë së Habeit (rreth 600 000 njerëz) .

Megjithëse sondazhet nuk siguruan të dhëna specifike për fetë e tjera, 90.61% e popullsisë janë ose jo fetare, ose janë të përfshirë në adhurimin e hyjnive të natyrës, Budizmit, Konfucianizmit, Taoizmit dhe sekteve fetare popullore.


Instituti për Studime Islame në Habei, themeluar në vitin 1992

HISTORI

Megjithëse zona e provincës së sotme Habei ka qenë e banuar shumë herët, për shumë shekuj me radhë ajo shtrihej jashtë sferës së shumicës së veprimtarisë politike dhe ekonomike të perandorisë kineze. Përpara përfshirjes në perandorinë Çin në shekullin 3-të (p.e.s), rajoni ishte i pushtuar nga shtetet Jan dhe Zhao.

Për sundimtarët e dinastisë Han (206 p.e.s.–220 e.j.), Habei ishte kryesisht një zonë kufitare përtej së cilës qëndronin armiqtë e tyre kryesorë, populli Shiongnu. Për këtë arsye iu kushtua një rëndësi e madhe mbrojtjes së rajonit me mure dhe garnizone të përhershme. Për perandorët ekspansionistë të dinastisë Tang (618–907 e.j.), Habei shërbeu si pikënisje për fushatat e mëdha që synonin pushtimin e Koresë.

Habei erdhi duke marrë një vend të rëndësishëm nën sundimin e një sërë dinastish me bazë veriore, përfshirë atë Liao (907–1125), Xhin (1115–1234) dhe Juan (1206–1368). Pekini u bë fillimisht kryeqyteti i të gjithë Kinës nën sundimtarët mongolë Juan, të cilët gjithashtu përfunduan punën e filluar nga Xhin për të ndërtuar Kanalin e Madh që lidh Habein me rajonet e rritjes së orizit në Kinën jugore.

Gjatë epokës së dinastisë Çing (1644–1911/12), provinca Habei u quajt Zhili dhe vazhdoi të ishte e rëndësishme strategjikisht, veçanërisht kur presioni i huaj imperialist u rrit gjatë shekullit të 19-të. Li Hongzhang, lideri kryesor ushtarak dhe politik i kohës së tij, shërbeu për shumë vite si guvernator i përgjithshëm i provincës Zhili, duke u pasuar nga Juan Shikai, i cili u bë president i republikës kineze në vitin 1912. Pas vdekjes së Juan Shikai në vitin 1916, Habei u drejtua nga një numër kryekomandantësh autonomë. Komandanti i luftës Jan Shishan vazhdoi të qeverisë në mënyrë të pavarur në Zhili (në provincën e riemërtuar Habei në vitin 1928) deri në pushtimin japonez, në vitin 1937.

Pas humbjes së Japonisë në vitin 1945, pushtuesit iu dorëzuan provincën nacionalistëve kinezë. Forcat komuniste kineze e morën provincën në Janar të viti 1949. Zona veriore e Habeit u zgjerua ndjeshëm në vitin 1952, atëherë kur përvetësoi pjesën juglindore të ish-provincës Çahar. Nga ana tjetër, territori i provincës u tkurr në vitin 1967, kur një zonë e madhe në lindje u mor prej saj për të krijuar qarkun autonom Tianxhin.

ISLAMI NË HABEI

Historia e popullsisë Hui muslimane në Habei[1]

Habei, toka e lashtë e Jan dhe Zhaos, kufizohet me detin Bo Hai në lindje, dhe me malet Taihang në perëndim.... Që nga shekulli i 13-të në Habei hynë një numër njerëzish Hui (muslimanë) që besonin në Islam. Ata punuan fort atje, krijuan familje dhe u shumuan, duke formuar

1. (Marrë nga faqja duost.com)

12

kështu popullsinë Hui në Habei, dhe u zhvilluan gradualisht. Popullsia Hui në Habei ka një histori të gjatë, e cila parë nga koha dhe burimi i migrimit të tyre në Habei, mund të ndahet përafërsisht në tri periudha. Periudha e parë ishte në fillim të shekullit të 13-të, kur një numër njerëzish Hui nga Azia Perëndimore dhe nga grupe të ndryshme etnike të Azisë Qendrore që besonin në Islam, erdhën në Kinë bashkë me ushtrinë mongole të Xhenghis Khanit dhe hynë në Habei.

Sipas "Historisë së Dinastisë Juan", gjatë sundimit të perandorit Taizong Ogedei (1229-1242 e.j), në zonën Shimalin (dikur e njohur si Shunmalin) në jugperëndim të Zhangxhiakou-t të sotëm, kishte më shumë se 3000 zejtarë Hui të ardhur nga rajonet perëndimore, të cilët prodhonin një lloj qëndisjeje të punuar me fije ari, të përzier me perla të mëdha dhe të vogla. Shumica e tyre ishin nga Samarkandi. Pasi lufta mongole për të bashkuar Kinën përfundoi, këta ushtarë që u përfshinë në ushtrinë "Tanma Chi" dhe mjeshtrit e prodhimit artizanal, vazhduan të qëndrojnë e të jetojnë në rajon.

Në shënimet për xhaminë e qytetit Dingzhou, në "Regjistrimet e rindërtimit të xhamisë", shkruhet: "Sot ka më shumë se 10,000 xhami në kryeqytet dhe në vende të ndryshme". Kjo fjali pasqyron faktin se njerëzit Hui (muslimanë) ishin të përhapur në të gjithë vendin në kohën e dinastisë Juan. Sipas "Ditarit të Qarkut Ding", të botuar gjatë kohës së Republikës Kineze, gjenerali Pu Janshuai Mu'er, i cili ruante zonën në atë kohë, ishte një Hui. Përveç Xhamisë së Dingzhou, ekzistojnë edhe xhamia Huangxhiaxhie në qarkun Vei, xhamia Jixhie në qarkun Ji, dhe xhamia e qytetit Xhintan në qarkun Daming, të cilat të gjitha janë ndërtuar në kohën e dinastisë Juan, gjë që tregon se gjatë kësaj periudhe kishte shumë njerëz Hui që jetonin në këto vende.

Mes njerëzve Hui që migruan në Habei gjatë dinastisë Juan kishte edhe njerëz të shtresës së lartë, të cilët shërbenin si zyrtarë të ndryshëm nën regjimin mongol. Pasi u dërguan në Habei, ata qëndruan dhe u vendosën të jetojnë atje.

Ky ishte migrimi i parë në shkallë të gjerë i njerëzve Hui në Habei. Shumica e këtyre njerëzve ishin ushtarë, zejtarë, zyrtarë dhe tregtarë nga Azia Perëndimore që iu bashkuan ushtrisë mongole. Disa nga ata ishin ende beqarë kur hynë në Habei. Pasi mbërritën në Habei, ata u martuan me gra lokale Han (kinezë autoktonë), lindën fëmijë, u shtuan, dhe u bënë pjesë e popullit Hui në Habei.

Periudha e dytë ishte në kohën e Dinastisë së hershme Ming. Rruga kryesore e migrimit ishte nga jugu në veri, përgjatë dy brigjeve të Kanalit të Madh.

Në vitin 1398, perandori Zhu Juanzhang vdiq nga sëmundja dhe ia kaloi fronin Zhu Çonguen-it, i cili ishte djali i djalit të madh të tij. Zhu Di, djali i katërt i perandorit Zhu Juanzhang, që ishte princi i rajonit Jan, ishte i pakënaqur që nipi i tij u bë perandor. Kështu kontradiktat e brendshme të klasës sunduese të dinastisë Ming u intensifikuan. Zhu Di luftoi kundër nipit të tij, Zhu Çonguen-it dhe ia mori pushtetin. Pasi Zhu Di u bë vetë perandor, ai lëshoi dekrete shumë herë për të zhvendosur njerëz nga Shansi dhe Xhiangnan për në Habei. Midis tyre pati një numër të madh njerëzish Hui që u erdhën nga vende të ndryshme në Habei. Të dhënat e Cangzhou, qarkut Daming dhe mbishkrimet ekzistuese në disa xhami, të gjitha tregojnë për migrimin e njerëzve Hui gjatë kohës së Dinastisë së hershme Ming.

Në zonën e prefekturës Cangzhou, ku popullsia Hui është më e madhja, njerëzit më të hershëm migruan nga Xhiangsu, Zhexhiang dhe nga vende të tjera gjatë kohës së Dinastisë së hershme Ming. Thuhet se janë tetë familje Hui me mbiemrat Zhang, Vang, Li, Liu, Jin, Dai, Ma dhe Hui, që kanë emigruar nga Erlanggang, Shangjuan, Jingtian dhe Nanxhing. Këta tetë mbiemra ishin emra të tetë komandantëve të dinastisë së hershme Ming. Pas migrimit, katër mbiemrat Jin, Dai, Ma dhe Hui u vendosën në perëndim të Kanalit të Madh, në zonën e qytetit Cangzhou dhe në qarkun Çing të sotëm. Katër mbiemrat Zhang, Vang, Li dhe Liu, u vendosën në zonën e Qarkut Autonom Mengcun Hui të sotëm.

Sipas dokumentit "Pema e familjes Zhang" të qytetit Mengcun: "Princi i provincës Jan të dinastisë Ming, e zhduku popullsinë e Zhili-t (Habei i sotëm) të Veriut. Më pas ai u ngjit në fron atje, hapi fusha, krijoi një familje dhe bëri plane për të ardhmen afatgjatë të pasardhësve të tij". Pas kësaj, më shumë se dhjetë familje Hui me mbiemra si Ding, Chang, Vu, Xhin, Jang, Han dhe Shiao u vendosën këtu, duke e bërë këtë zonën më të populluar të vendbanimeve Hui. Deri më sot, këta mbiemra përbëjnë ende shumicën e njerëzve Hui në Cangzhou, Habei.

Një zonë tjetër e vendbanimeve Hui me një numër të madh banorësh muslimanë në Habei është zona e Dachang. Në vitin e 19-të të Jongle në dinastinë Ming (1421 e.j), Zhu Di e zhvendosi zyrtarisht kryeqytetin në Pekin. Me zhvendosjen e kryeqytetit, qendra politike dhe ekonomike e dinastisë Ming u zhvendos në veri dhe një numër i madh zyrtarësh, biznesmenësh dhe familjesh të pasura sollën familjet e tyre në veri, përfshirë edhe njerëzit Hui. Sipas "Pema Familjare Hai", e qytetit Dachang, Hai ishte një zyrtar në gjykatë dhe shumë të afërm të tij u shpërngulën këtu me të, kështu që këtu u formua një fshat i dominuar nga familja Hai. Pas kësaj, këtu u vendosën edhe të tjerë njerëz Hui, duke formuar më shumë se një duzinë vendbanimesh Hui, si Dachang, Beivu dhe Nanshitou, në këtë zonë.

Periudha e tretë ishte në fund të dinastisë Çing. Në fillim të shekullit të 19-të shpërtheu Lëvizja e "Mbretërisë Qiellore Taiping", që tronditi të gjithë vendin. Në të njëjtën kohë, me intensifikimin e kontradiktave të ndryshme sociale dhe etnike, në provincën Junnan dhe në Kinën Veriperëndimore shpërthyen kryengritjet e popullsisë Hui në shkallë të gjerë.

Qeveria Çing ndoqi politikën e shtypjes brutale dhe të masakrës brutale kundër ushtrisë kryengritëse Hui në vende të ndryshme. Pasi kryengritja u shtyp, njerëzit Hui në këto vende duhej të braktisnin shtëpitë e tyre dhe të fshiheshin ku të mundnin për t'i shpëtuar persekutimit nga regjimi. Disa prej tyre u zhvendosën në vende të ndryshme në provincën Habei. Përveç kësaj, për shkak të viteve të fatkeqësive natyrore në provincën kineze Shandong, një numër i madh njerëzish Hui u zhvendosën në Habei.

Një pjesë e madhe e popullit Hui në Chengde, Zhangxhiakou dhe vende të tjera erdhën nga vende të ndryshme gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, numri i njerëzve Hui që u shpërngulën në Habei gjatë kësaj periudhe (periudhës së tretë) nuk ishte aq i madh dhe nuk u krijuan vendbanime të mëdha të tyre me këtë rast.

Tregtarët Hui që migruan në Habei në periudha të ndryshme, janë edhe ata një nga burimet e shtimit të popullsisë Hui muslimane në provincën kineze Habei.

Përgatiti:

Msc. **Arta Ujkaj**, *teologe*


http://www.duost.com
https://en.wikipedia.org
https://www.britannica.com
http://www.chinaislam.net

"JEHONA E ZEMRAVE" - 15 VITE

Po vinte fundi i dekadës së parë të shekullit të ri dhe pavarësisht formave te reja mediatike që po endeshin në treg, njerëzit ende mbeteshin të lidhur me tingullin, valën e fjalën.

Televizioni, ekrani i vogël që të sillte në shtëpi gjithë botën e madhe, nuk kishte mundur që të ishte aq intim, aq i afërt e aq "NJË" me njerëzit sa "motra e tij e madhe", radioja!

Shkodra e atyre viteve herë përmbytej në Dajç e herë plazhitej në Velipojë, duke bërë që qytetarët të kërkonin të ishin gjithmonë të lidhur me realitetin, afër apo larg tyre pastë qenë ai.



Në hyrje të qytetit të bukur, ndodhej një kodër, ne fakt disa, me shumë shkallë deri në majë të tyre, që duket se te çonin drejt pamjeje pikture, e cila nuk ishte asgjë më shumë se "e dashura e shekujve" në miniaturë.

Nga aty, çdo fjalë dukej sikur jehonte deri në gurin më të largët të kufirit të qytetit.

Dhe pikërisht në atë kohë, në atë vend e në atë kënd, Jehona mori krahë e valë dhe u bë Radio!

22 maji i vitit 2009 po e bënte Veriun më të pasur nga ana kulturore dhe mediatike për shkak se një grup intelektualësh vendosen t'i jepnin jetë një projekti, i cili do të bëhej shumë shpejt shoqëruesi i pandarë i ditëve të dëgjuesve.



Në fakt ora 16:00 e asaj dite të xhuma, do ishte kurorëzimi i një pune që kishte nisur që në vitin 2008, kur u bë aplikimi dhe më pas marrja e licencës nga KKRT (sot AMA).

Dhe gjithçka gati...

105, 106... 107.6 MHz/FM, jeni në valët e Radio Jehona!

Emocion, zemrat peshë, edhe një tel që duhej lidhur, edhe një fish që duhej vënë... edhe...edhe... edhe...

Programacioni i larmishëm i zërit më të ri mediatik në qytet kishte nisur të tërhiqte vëmendjen. Ai ndërthurte informacionin, argëtimin, zbavitjen, muzikën më të mirë, emisionet edukative, të ftuarit më të veçantë dhe dëgjuesit "i bënë veshët katër" për të kuptuar se kush ishte kjo radio ndryshe.

Vala harmonike e ditës kthehej më pas në tingullin e qetë të natës me programe shpirtërore/fetare e morale që tregonin se njeriu ka vetëm një detyrë të madhe në këtë dynja... të jetë njeri, të njohë raportet paqësore me veten, më njerëzit dhe më Zotin Fuqiplotë!

Në makinë, në shtëpi, në telefon, në punë, kudo Jehona, Jehona, Jehona!

Përveç se një media që doli shpejt nga duart e krijuesve dhe u bë "pronë" e të gjithë veriut, godina e Radio Jehonës ka mirëpritur në këto 15 vite miq të shumtë, personalitete nga vende të ndryshme të botës, nxënës e studentë që panë nga afër ambientet "farmaceutike" të një investimi serioz.



Emri i kësaj radioje shpejt arriti në nivele qendrore të medias në Shqipëri, aq sa në vitin 2013, kur ishte ende "një fëmijë" 4 vjeç, u shpall nga Media Center, pas disa sondazheve serioze e rigoroze si "Radio më e dëgjuar në Qarkun e Shkodrës, por edhe në veriun e Shqipërisë".

Nuk mund të kishte duartrokitje më të mirë që do të thante nga balli djersën e mundit të grupit krijues...

Radiostacioni Jehona ka qenë gjithë këto vite edhe "shtëpia e parë" mediatike e shumë të rinjve, duke u bërë ushqyes i pasionit të tyre, dhe realiteti i parë i një bote ëndrrash.



Valët e kësaj radioje, sot 15 vite pas krijimit shtrihen në Shkodër, Malësi e Madhe. Pukë, Lezhë, Kruje, Laç, Fushë Krujë, Burrel, Bulqizë, pjesërisht në Durrës dhe Tiranë, por edhe në trojet shqiptare si në Tuz, Ulqin Krajë, Podgoricë, etj.

Numri i dëgjuesve që kanë mundësi të ndjekin "Jehonën" në kohë reale në FM i kalon 900 mijë... dhe miliona u bëfshin!

Vitet janë vetë numra, por numrat kanë brenda tyre vitet e përpjekjeve, mundit, lodhjes, sakrificës, përkushtimit dhe angazhimit që e kane bërë Jehonën një pasuri të shkodranëve dhe zotohemi që vetëm atyre do ua lëmë amanet dhe testament!

Gëzuar ditëlindjen "Radio Jehona", qofsh gjithmonë ura që lidh veshët me shpirtin e dëgjuesve dhe e të gjithë atyre që kudo që janë, ndihen nga pak shkodranë!

Zoti na ndihmoftë të gjithëve në këtë mision shpirtëror, edukativ, kulturor dhe informativ!

Mirënjohje dhe falënderime për të gjithë ata që kanë kontribuar dhe kontribuojnë për këtë media të rëndësishme radiofonike!

RADIO JEHONA/ FM 107.6 MHz

dhe Online në Facebook, X dhe Web

Radio Jehona me ju dhe për ju!

BASHKIA E BOLONJËS NË ITALI NGRE FLAMURIN PALESTINEZ..!

"Ne mbajmë anën e viktimave dhe të drejtave të njeriut", tha mes të tjerash kryebashkiaku Matteo Lepore.

Bashkia e Bolonjës në Itali ngriti flamurin palestinez të mërkurën në shenjë solidariteti me popullin palestinez në mes të sulmit në Rripin e Gazës, njoftoi agjencia shtetërore të lajmeve ANSA.

"Si kryebashkiak i një qyteti që historikisht bën fushatë për paqen, jo dhunën dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, është detyrë për mua të mbaj një qëndrim dhe të veproj për të siguruar kohezionin më të madh social të mundshëm në qytetin tonë", citon ANSA kryebashkiakun, Matteo Lepore.

"Kjo është arsyeja pse ne do të mbajmë flamurin palestinez së bashku me një flamur që bën thirrje për armëpushim. Ne mbajmë anën në favor të viktimave dhe të drejtave të njeriut, edhe një herë. Nuk mund dhe nuk do të qëndrojmë në heshtje", thekson Lepore.

Ai tha se Bolonja do të valojë gjithashtu edhe flamurin izraelit kur Tel Avivi të ndalojë ofensivën e tij në Gaza.

Izraeli ka nisur një sulm brutal në Gaza që nga 7 tetori, pas një sulmi të Hamasit, duke vrarë më shumë se 36.171 viktima dhe duke plagosur të paktën 81.420 të tjerë.

Gati tetë muaj pas ofensivës izraelite, zona të gjera të Gazës ishin në gërmadha mes një bllokade gjymtuese të ushqimit, ujit të pastër dhe ilaçeve.

Izraeli akuzohet për "gjenocid" në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, e cila në vendimin e saj të fundit ka urdhëruar Tel Avivin të ndalojë menjëherë operacionin e tij në Rafah, ku më shumë se 1 milion palestinezë kishin kërkuar strehim nga sulmi përpara se të pushtohej më 6 maj.

(radiojehona.al)





Dr. Jusuf El-Karadavi
(1926-2022)

Në kohën, kur fitnet (trazirat) janë shtuar dhe mbajtësi i fesë është sikur, ai që mban gacën (zjarrin) në dorë; bëhet obligim për secilin prej nesh të ndihmojmë njerëzit të fetarizohen, e jo t'i largojmë ata nga feja.

Ne e dimë mirë, se ashpërsia largon, ndërkohë lehtësimi i ndihmon njerëzit të afrohen nga feja!

TAKIM DHE VEPRIMTARI ME NXËNËSIT E MEJTEPIT DHE PRINDËRIT E TYRE NË XHAMINË MES-MYSELIM



Myftinia Shkodër, përmes sektorit të arsimit zhvilloi më 3 maj 2024, pas namazit të xhumasë, një takim më nxënësit e mejtepit, në prani edhe të disa prindërve të tyre në xhaminë e Mes-Myselimit.

Fillimisht, drejtuesi i arsimit teologu Arben Halluni vizitoi godinën e mejtepit të ri që është në përfundim të punimeve dhe po ndërtohet me kontributin e banorëve të zonës si dhe me mbështetjen e Myftinisë Shkodër.

Më pas, u zhvillu takimi, ku teologu Halluni gjatë bisedës së tij, foli për rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i kurseve fetare, sidomos më fëmijët dhe brezin e të rinjve, ku kërkoi më shumë bashkëpunim nga ana e prindërve për të edukuar bashkërisht fëmijët e tyre më frymën e besimit, të adhurimit dhe moralit më të mirë islam.

Kjo veprimtari, ku të pranishëm ishin edhe mësuesit Fatmir Sulaj dhe Naile Sulaj u mbyll më shpërndarjen e dhuratave për gjithë secilin nxënës dhe nxënëse dhe me një koktejl të përgatitur enkas për këtë rast.









Pejgamberi (a.s) ka thënë:

Tri gjëra; kush i posedon, ka shijuar ëmbëlsinë e besimit:

- Të jetë Allahu dhe i Dërguari i Tij më të dashur për të sesa kushdo tjetër;

- Ta dojë tjetrin, për asgjë tjetër vetëm se për hir të Allahut;

- Si dhe të urrejë kthimin në femohim, pasi Allahu e shpëtoi prej tij, siç urren të hidhet në zjarr!

(Transmetuar Ahmedi, Bukhariu, Tirmidhiu, Nesaiu dhe Ibn Maxheh, nga Enesi)

EKSKURSIONE EDUKUESE DHE ARKËTUESE ME NXËNËSIT E MEJTEPEVE



Nën kujdesin dhe mbështetjen e Myftinisë Shkodër, mejtepet e xhamive Bardhaj dhe Mes-Myselim zhvilluan ekskursione edukuese dhe argëtuese në Prizren dhe Pukë, pikërisht më 4 maj dhe 25 maj 2024.

Nxënësit e mejtepit të xhamisë Bardhaj nën shoqërimin e imamit dhe mësuesit të tyre, H. Ilir Dizdari gjatë qëndrimit në qytetin e bukur të Prizrenit, vizituan vende historike të këtij qyteti antik, trashëgiminë kulturore, xhaminë Sinan Pasha, etj.

Një tjetër vizitë interesante ishte qyteti i Pukës, ku nxënësit e mejtepit të xhamisë Mes-Myselim, nën shoqërimin e imamit dhe mësuesit të tyre, H. Fatmir Sulaj vizituan vendet më atraktive të kësaj zone të veçantë natyrore, ku sigurisht nxënësit ndihmohen për të kuptuar më shumë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimin e tij.

Natyrisht, këto ekskursione janë pjesë e rëndësishme e edukimit të nxënësve, duke u ofruar mundësi të reja për të mësuar, argëtuar dhe për të zgjeruar horizontet e tyre në të gjitha drejtimet.





AFROHESH..DHE, NUK DËSHIRON TË SHKËPUTESH MË!



Afrohesh dhe prek fillin e besimit dhe bindjes së palëkundur, se kuptimet e vërteta të Dashnisë, burojnë nga afrimiteti me Krijuesin, jo nga lidhja e verbër dhe naive me krijesat, interesat kalimtare, postet lakmitare dhe intrigat mjegulluese të botës materiale!

Afrohesh dhe dëgjon zërin e arsyes që thërret, mjaftueshëm për ta dëgjuar vetëm ti: “Lëri krijesat me Zotin e tyre!”.., mjafton që të marrësh frymë lirisht e i pavarur nga rëndesa e krejt situatave të jetës!

Afrohesh dhe sheh gjithësinë me detajet e saj, në pasqyrën e padukshme të Thirrjes hyjnore: “Përulu dhe afrohu!”

Afrohesh dhe, tanësia mbetet pas shpine, gjurmë për t’u harruar, stacion sprove e mundësi e hapur afrimi!

Afrohesh dhe, në rrahjet e çdo sekonde, akrepat e orës të tërheqin drejt madhështisë së vendosmërisë në rrugën e Besëlidhjes!

Afrohesh dhe, sa e sa perde bien para syve të zemrës.., teksa e gjen veten mbështjellë me qefinin e shkëputjes!

Ka veç një dilemë; bardhësi a koka pas..?!

Afrohesh.. dhe, nuk dëshiron të shkëputesh më!

Imam Muhamed B. Sytari

Një me Qaben e Madhnueshme, natë xhumaje, më 17 maj 2024

IMAM DIDMAR FAJA: “MEDRESEJA JONË NË ARIZONA, DERË E HAPUR E DIJES!”

Paraditën e së mërkurës, më 22 maj 2024, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt e vëllazëror, Kryetarin e Komunitetit Mysliman Shqiptar në Arizona, Imam Didmar Faja, që ndodhet në vendlindje për një vizitë të shkurtër.

Gjatë takimit të përzemërt, u diskutua rreth aktivitetit të përbashkët, gjallërimit të Thirrjes Islame në çdo cep të globit dhe rreth zhvillimeve të reja në shoqërinë shqiptare.

Myftiu Sytari dëgjoi me kënaqësi lajmet e gëzueshme të aktivitetit përherë në rritje të vëllait të tij, Imam Didmar Faja, i cili e lajmëroi edhe për aktivitetin e medresesë së re “Greenway Academy”, që ai drejton në Arizona.

Imam Didmar Faja theksoi se dera e medresesë në Arizona është e hapur për kërkuesit e dijes dhe se vit pas vitit, ajo rritet, duke u kthyer në një institucion arsimor me vlerë.



Imam Didmar Faja, është njëkohësisht edhe imam i Qendrës së Bashkuar Islame të Arizonës (United Islamic Center of Arizona) në ShBA.

Ai është themeluesi dhe kryetari i bordit të shkollës (Greenway Academy), dhe gjithashtu, themelues i dy Qendrave Islame në Meksikë: Centro Islámico Unido de Sonora dhe Centro Islámico Unido de Durango.

TAKIM PERIODIK MË IMAMËT E SHKODRËS

Pas ditën e xhuma, më 24 maj 2024 në ambientet e xhamisë “Ebu Bekër”, Fushë Çelë, u zhvillua mbledhja më imamët e Myftinisë Shkodër.

Fillimisht, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari ka falënderuar angazhimin e imamëve në shërbim të thirrjes Islame në xhamitë ku shërbejnë dhe përtej saj.

Myftiu kërkoj gjatë bisedës së tij, që imamët të gjallërojnë edhe më tepër jetën fetare, përmes të gjitha aktiviteteve, sidomos në këtë periudhë sfidash dhe propagande islamofobe dhe përpjekjeje për tjetërsimin e natyrshmërisë së familjes.

Gjatë takimit të tij me imamët, ka folur edhe përgjegjësi i arsimit, teologu





Arben Halluni, ku i ka kërkuar për të vazhduar angazhimin në përmirësimin dhe hapjen e mejtepeve të reja në xhamitë që shërbejnë. Ai më këtë rast ka paraqitur edhe projektin e aktivitetit të madh të radhës së sektorit të arsimit, ku në krye të saj do të jetë konkursi fetar, edicioni i 12-të, i cili pritet të zhvillohet në fund të muajit qershor 2024, me pjesëmarrjen e të gjitha mejtepeve të xhamive të qytetit dhe të fshatrave.

Në këtë takim, ishte i pranishëm edhe Imam Didmar Faja, kryetar i Komuniteti Mysliman Shqiptar të Arizonës në ShBA, ku përmes një përshëndetje solli përvojën e tij të davetit/thirrjes të tij të suksesshme islame në Amerikë.

NË MËSHIRËN E ALLAHUT, H. SAMI MUÇEJ!

"Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi!"



Ngushëllim!

Myftinia Shkodër shpreh ngushëllimet e saj me rastin e ndërrimit jetë të aktivistit veteran të leximit të Mevludi Sherifit, të nderuarit H. Sami Muçej, i cili u nda nga jeta ditën e sotme, më 31 maj 2024, në moshën 90 vjeçare.

Vlen të përmendet, se gjatë këtyre 30 viteve të fundit, zotëria i tij është angazhuar në aktivitetet e shumta dhe të larmishme të Myftinisë së Shkodrës, në xhami dhe në qytetet e ndryshme të Shqipërisë, por edhe jashtë saj, me këndimin e pjesëve të Mevludi Sherifit dhe ilahive të vjetra, të cilat i këndonte sipas mekameve të shquara të hoxhallarëve dhe ilahistëve të shquar të qytetit të Shkodrës ndër shekuj.

Përgjatë viteve Myftinia Shkodër e ka vlerësuar kontributin e zotërisë së tij, H. Sami Muçej, duke e vlerësuar disa herë me Certifikatë Mirënjohjeje, duke vlerësuar punën dhe kontributin e tij të paçmuar.

Në vitin 2017, zotëria e tij, pati mirësinë t'i dorëzojë Myftiut të Shkodrës, arkivin e Mevludit Sherifë, në përbërje të së cilit ishin fletoret me ilahi të vjetra, regjistrimi i shumë aktiviteteve dhe veprimtarive me rastin e Mevludi Sherifit në qytetin e Shkodrës, por jo vetëm.

Me këtë rast Myftinia Shkodër shpreh ngushëllimet e saj për familjen Muçej, rrethin e gjerë të besimtarëve dhe lutet, që Allahu i Madhëruar ta mëshirojë, ta pranojë veprën e tij dhe ta bashkojë me njerëzit e mirë në xhenetet e Tij në jetën e përtejme.

Lajmërojmë, se xhenazja e tij do të falet ditën e shtunë, më 1 qershor 2024, ora: 13.00, pranë xhamisë së lagjes Perash.

"Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi!"





Pejgamberi (a.s) ka thënë:

"Duaja më e pëlqyer është t'i lutesh Zotit tënd për faljen dhe shpëtimin në këtë botë dhe në të përtejmen! Sepse, nëse të jepen këto dy lutje në këtë botë, pastaj edhe në të përtejmen, ti ke triumfuar!"

(Transmetuar nga Ahmedi, Henadi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxheh, nga Enesi)

MEJTEPI IM... XHAMIA FSHATI I RI, POSTRIBË

Pak histori:

- Xhamia e fshatit "Fshati i Ri" ndodhet në Njësinë Administrative Postribë, Bashkia Shkodër.

- Aktualisht, "Fshati i Ri" është 100 % mysliman dhe përbëhet me rreth 160 familje.

- Fiset më të njohura janë: Meaj, Lumaj, Ndreaj, Cekaj, Papaj, Legataj, Lisaj, etj.

- Në vitin 2007 me iniciativën dhe financimin e banorëve të fshatit si dhe me mbështetjen e gjithanshme të Myftinisë Shkodër, filloi ndërtimi i xhamisë së re, ndërsa në vitin 2010 u bë inaugurimi i saj.





- Imamët e xhamisë "Fshati i Ri" dhe njëkohësisht edhe mësues të mejtepeve që kanë shërbyer nga viti 2010 dhe në vazhdim janë: Ruzhdi Plangaj dhe imami dhe mësuesi aktual, Indrit Plangaj

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 12 mejtepe dhe kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në periudha të ndryshme nga viti 2010-2024 është rreth 320 nxënës.

Takimi me nxënësit:

Sektori të arsimit pranë Myftinisë Shkodër, në vijim të takimeve me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset/mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi dhe inspektori i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi ditën e xhuma, më 31 maj 2024 një takim me nxënësit e mejtepit/kursit fetarë në xhaminë "Fshati i Ri", me praninë e mësuesit H. Indrit Plangaj.

Drejtuesi i arsimit, pasi u njoh me ecurinë e procesit mësimor, zbatimin e programit, pjesëmarrjen e nxënësve në kurs/mejtep, etj, u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin si përçimin te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit, me krijesat e Zotit në tokë, etj.

Në fund, u zhvillua edhe një bashkëbisedim me pyetje-përgjigje rreth mësimeve që marrin nxënësit në këtë mejtep si dhe u rikujtua zhvillimi i konkursit të madh fetar dhe aktiviteteve të tjera argëtuese, të cilat priten të zhvillohen më 29 qershor 2024.



29 MAJ 1453 - ÇLIRIMI I KOSTANDINOPOJËS



"Biri im, përhapja e Islamit në tokë është detyrë e mbretërve,
puno për përhapjen e fesë së All-llahut sa të mundesh!
Biri im, le të jetë fjala e fesë mbi çdo fjalë tjetër!
Mos lër pas dore asnjë urdhër nga urdhrat e fesë...
Biri im, mbaji afër vetes dijetarët dhe madhëroje pozitën e tyre..."

(porosia që Sulltan Mehmet Fatihu i la të birit, Bajazidit II)

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek